DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-799/4 -III-
Data Datum Date 03.07.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

---

Datë. 26.06.2013
Nr. 0204-799

**PËR:** Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
Xhavit Zariqi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt,

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT 01.Nr.42, të pranuar më datën 19.06.2013.**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit, 01. Nr.42, të miratuar me datë 29.05.2013, ***KONFIRMON*** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 .Nr.42, për Shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastral Nr.2337-0, si dhe pjesët e ngastrave kadastrale Nr.2336-1,2336-2 dhe 2338-0.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-799/4
-III-
Data Datum Date 03.07.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum. 26.06.2013
br. 0204-799

**Za:** Agim Aliu, Gradonačelnik opštine Uroševac
Xhavit Zariqi , Predsedavajući Skupštine opštine Uroševac ,

Predmet: **Potvrda zakonitosti odluke opštine Uroševac 01.br.42, primljeno dana 19.06.2013.**

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim adminstativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke, 01. br.42, odobreno dana 29.05.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01 .br.42, o objavljivanu od opšteg interesa katastarske parcele br.2337-0 kao i delovi katastarske parcele br.2336-1,2336-2 i 2338-0.

Sa poštovanjem.

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*
*Arhivi MALS-a.*

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komuna e Ferizajt - Opština Uroševac - Municipality of Ferizaj
Drejtoria e Administratës dhe Personelit - Uprava Administracije i Osoblja
Data / Datum / Date / Dana 29.05.2013
Nr. Org. / Org. jed. 01 | Nr. Prot. / Br. Prot. 42 | Nr. Faqeve / Br. Strana 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

| KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | 01.Nr. 42<br>Data: 29.05.2013 |
|---|---|

Në bazë të nenit 18 (a) të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 4 të Ligjit për Shpronësim nr. 03/L – 139, Ligjit për këmbimin e pronave dhe dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nr. 04/L - 144 dhe nenit 28.12 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën 29.05.2013 mori :

# V E N D I M
## PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR NGASTRËN KADASTRALE NR. 2337-0 SI DHE PJESËT E NGASTRAVE KADASTRALE 2336-1, 2336-2 DHE 2338-0

I

Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm për ngastrën kadastrale nr. 2337-0 si dhe pjesët e ngastrave kadastrale 2336-1, 2336-2 dhe 2338-0, zona kadastrale Komogllavë - Ferizaj me pronarët Daut Osmani, Naser Hajredini, Agim Hajredini dhe Tair Ajeti me qëllim të realizimit të projektit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Komogllavë.

II

Ngastra kadastrale dhe pjesët e ngastrave kadastrale të cekura në pikën një të këtij vendimi kërkohen me qëllim të realizimit të projektit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Komogllavë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të tjetërsohen dhe as t'u ndërrohet destinimi pa vendimin e Kuvendit të Komunës së Ferizajt.

III

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të kryej të gjitha procedurat e nevojshme për ekspropriijm të kësaj prone sipas ligjit. Është e domosdoshme që kjo procedurë të kryhet në afat sa më të shkurtër në mënyrë që komuna t'iu ikë përgjegjësive pronësoro-juridike.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesuesi i KK-së
Xhavit Zariqi

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Kuvendi i Komunës - Skupština Opštine - Ferizaj - Uroševac